



BIZNESI NË KOSOVË... ÇDO DITË E MË LEHTË!



Reformat që janë ndërmarrë deri më tani për të bërit biznes:

Është eliminuar leja e punës, numri i dokumenteve për import / eksport është reduktuar, regjistrimi i biznesit bëhet pa pagesë, kapitali themeltar për SHA-të dhe SHPK-të është zvogëluar dukshëm, janë eliminuar një numër i konsiderueshëm i licencave, janë hapur One Stop Shop-e nëpër qendra komunale...

REFORMAT E TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË

Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është duke ndërmarrë hapa të vazhdueshëm për të krijuar kushte dhe lehtësira për të bërë biznes. Gjatë periudhën njëvjeçare (mars 2011- mars 2012) janë ndërmarrë hapa konkretë për të reformuar dhe lehtësuar aktivitetin afarist në Kosovë.

INVESTIMET NË KOSOVË



Investimet e huaja në Kosovë në vitin 2011, në krahasim me vitin e kaluar, kanë pasur ngritje. Sipas Bankës Qendrore në Kosovë, gjatë 6 muajve të parë të vitit 2011, ka pasur rritje të investimeve në Kosovë, prej 15 për qind, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Politikat e institucioneve të Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe në koordinim me Agjencinë për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK) kanë qenë në shërbim të rritjes së

investimeve të huaja në Kosovë. Janë organizuar konferenca me investitorë të huaj për t'i prezantuar potencialet që ofron Kosova, si dhe duke marrë pjesë në samite dhe forume të ndryshme biznesore për sensibilizimin e mundësive investuese.

APIK përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme ka bërë iniciimin e Marrëveshjeve për Mbrojtje dhe Promovim të Investimeve në më shumë se 15 shtete për t'i siguruar investitorët e huaj se investimet e tyre në Kosovë janë të sigurta dhe trajtimi i investitorëve të huaj është i njëjtë sikur i atyre vendorë. Marrëveshje të tilla, deri me tani, janë nënshkruar me Shqipërinë, Austrinë, Belgjikën, Luksemburgun, SHBA-në dhe Zvicrën. Këto marrëveshje mundësojnë siguri dhe mbrojtje për çdo investitorë të huaj, trajtim të drejtë dhe të barabartë të investitorëve

Për ngritjen e imazhi të Kosovës, që ndikon dukshëm në tërheqjen e investimeve, ka filluar edhe fushata e promovimit të Kosovës në Televizionin më të shikuar botëror - CNN për të treguar se Kosova është vend normal, stabil dhe që ofron kushte të favorshme për investime.

vendorë dhe atyre të huaj, transferim i lirë i mjeteve duke përfshirë kapitalin fillestar, fitimet etj, promovimi reciprok i investimeve, si dhe zgjidhjet të kontesteve eventuale që kanë të bëjnë me investimet e huaja.

Po ashtu, me datën 6 mars, APIK dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe të promovimit të potencialeve për investime që ofron Republika e Kosovës.

Investimet e huaja të deritanishme?



Që nga viti 2000 e deri më tani, sipas ARBK-së, në Kosovë janë regjistruar 4300 biznese me kapital të huaj. Ndërkaq, sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) Investimet e Huaja Direkte (IHD) kapin shumën prej 1,6 miliard eurosh për periudhën 2007 deri në gjysmën e vitit 2011. Viti 2008 ka qenë viti kur kriza ekonomike i ka goditur ekonominë më të fuqishme të botës dhe kjo është reflektuar edhe në uljen e IHD-ve, në nivel botëror, e që ka ndikuar edhe në Kosovë. Mirëpo në vitet 2010 dhe 2011, IHD-të në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme, në vitin 2010 deri në 20 për qind dhe në vitin 2011 ka pasur rritje deri 24 për qind.

Zhvillimi i politikave të inovacionit

Pas një kooperimi të ngushtë në mes të sektorit publik dhe atij privat, Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të



Mesme (AMNVM), që vepron në kuadër të MTI-së, lansoi projektin e përzgjedhur kohë më parë, me temë "Zhvillimi i politikave të inovacionit". Ky projekt është përzgjedhur më 27 tetor 2011, gjatë tryezës me temë "Iniciativa e Ballkanit Perëndimor për Konkurrencën Regjionale" ku është bërë konsultimi i njëzetekatër pilot-projekteve nga dokumenti "Drafti i Iniciativave të Ballkanit Perëndi-

morë për Konkurrencën Regjionale – opsionet për mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve". AM NVM-ja si pjesëmarrëse në "Iniciativa e zhvillimit të Ballkanit Perëndimor për konkurrencën Regjionale", pas një pune disamujsh bashkëpunimi me mes sektorit publiko-privat, mundësoi implementimin e këtij projekti, ku si për produkt ka strategjinë mbi inovacionet dhe planin aksionar.

Bizneset nënshkruajnë kontratat për vendosje në Parkun e Biznesit

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në vargun e projekteve të veta, për krijimin e lehtësirave të të bërit biznes dhe për krijimin e kushteve më të favorshme në zhvillimin ekonomik të Kosovës, është duke mbështetur sektorin privat, për t'ia lehtësuar aktivitetin afarist, në këtë rast me ndarjen e parcelave në hapësirat e Parkut të Biznesit në Drenas. Parku ofron një infrastrukturë të gatshme për biznese, i cili në fund të vitit 2011 ka pasur 21 biznese të vendosura dhe me datën 13.03.2012 janë nënshkruar edhe 12 kontrata të reja, duke arritur në 33 numrin e bizneseve të vendosura. Qëllimi tjetër është që brenda 24 muajsh të arrijë shumën prej mbi 30 milionë eurosh investime dhe me mundësi të punësimit të 1000



punëtorëve. Nga investimi total, 2 milionë e 650 mijë euro janë investime të huaja dhe 10 milionë e 760 mijë e 380 euro bashkë-investime (të huaja dhe vendore). Me projekte të tilla MTI-ja do të jetë gjithmonë pranë bizneseve dhe në përkrahje të vazhdueshme për arritjen e sukseseve të mëtejshme, si në zhvillim të tregut të brendshëm po ashtu edhe në arritjen e konkurrencës me kompanitë në rajon e me gjerë.

Rregulla të reja për tregtim të derivateve të naftës

Me ndryshimin e Ligjit për tregti me naftë dhe derivate të naftës do të bëhet edhe organizimi i rezervave të naftës, që do të ndahen në: *Rezerva Obliguese* (së paku për 90 ditë të importit mesatar vjetor të vitit paraprak) për të cilat do të duhet aprovimi nga Këshilli Evropian për përdorim, dhe *Rezerva Strategjike* (pasi të përmbushet obligimi prej 90 ditësh) për të cilat sasia dhe vendndodhja do të mund të ishte sekrete dhe nuk do të nevojitej ndonjë aprovim nga Këshilli Evropian. Një ndër aspektet themelore të MTI-së është

kontrollimi i cilësisë së naftës dhe derivateve të naftës në Republikën e Kosovës. Për të realizuar cilësinë e derivateve të naftës është hartuar UA nr 17/2011, që rregullon këtë fushë, si dhe është hartuar plani i monitorimit të cilësisë së naftës dhe derivateve të naftës. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bazë të UA 17/2011 dhe 16/2011 për autorizimin e Trupave për Vlerësim të Konformitetit (TVK), ka bërë autorizimin e dy trupave inspektuese dhe tre laboratorëve testues. Gjatë këtij viti do të fillojë edhe përgatitja e statistikave të cilësisë për secilin karburant.

JAVA E KOSUMATORIT

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) edhe këtë vit ka organizuar "Javën e konsumatorit" nga data 12-16 mars, ashtu siç është paraparë edhe me Programin për mbrojtjen e konsumatorëve 2010-2014. Gjatë kësaj jave, Zyra për mbrojtjen e konsumatorit në MTI ka organizuar një varg aktivitete me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe informimit të konsumatorëve për të drejtat e tyre. Për sensibilizimin e konsumatorëve janë mbajtur edhe ligjërata në universitete të ndryshme, si dhe janë organizuar tryeza të rrumbullakëta.


Me datën 13 mars, në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë, përfaqësuesit e Zyrës për mbrojtjen e konsumatorit kanë mbajtur ligjëratë rreth të drejtave të konsumatorëve; ndërsa me 14 mars në Fakultetin Juridik janë sqaruar procedura e ankimit dhe të zgjidhjes së lëndëve. Po ashtu me 15 mars, në hotelin "Swiss Diamond", me rastin e "Ditës Ndërkombëtare të Konsumatorëve" është mbajtur tryeza e rrumbullakët për "Rolin dhe rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorëve".

Janë bërë inspektime të vazhdueshme nëpër të gjitha rajonet e Kosovës, ku Inspektorati i Tregut në MTI-së dhe në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar të Kosovës kanë konfiskuar 45.100 kilogram produkte ushqimore, 131 litra pije alkoolike, 45.5 litra pije jo-alkoolike të gazuara, si dhe 78 litra pije jo alkoolike (lëngje).



Inspektimet e pikave të Karburanteve

Gjatë inspektimit të pikave të shitjes të karburanteve, Inspektorati i Tregut në Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë ka shqiptuar gjoba për bizneset që shesin karburante jociësore. Këto gjoba janë shqiptuar për shkak se kanë shitur naftë në kundërshtim me Udhëzimin administrativ nr. 2011/17 për cilësinë e naftës. Kontrolle të tilla, në pikat me shumicë edhe në ato me pakicë, do të ketë çdo herë dhe pa paralajmërim derisa të largohet nga tregu nafta jociësore.



Turizmi

Në kuadër të aktiviteteve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgatitur edhe ndryshimplotësimi

i Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike, që ka për qëllim përmirësimin e turizmit në përgjithësi. Në plotësimet e ligjit janë paraparë edhe lehtësira, që do të ndikojnë dukshëm në zhvillimin e turizmit, si dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.



MASAT TREGTARE PREFERENCIALE

Me rikthimin e preferencave tregtare nga BE-ja, përfitimet e Kosovës janë të mëdha. Ndërmarrjet prodhuese nëse i plotësojnë standardet evropiane dhe ndërmarrjet eksportuese mund të shesin mallrat kosovare në këtë treg të madh me një çmim me konkurrues apo më të lirë për shkak se nuk ngarkohet çmimi shitës i mallit me taksë doganore. Me këtë forcohen bizneset kosovare, por gjithashtu edhe në

aspektin nacional përmirësohet bilanci tregtar dhe bruto prodhimi vendor, krijohen mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës, ngritjen bashkëpunime me të thella me bizneset nga BE-ja, etj. BE-ja për Kosovën paraqet partnerin kryesor tregtar dhe se statistikisht tregtarët tregtojnë trendet pozitive në drejtim të qarkullimit tregtar me BE-në dhe në këtë drejtim edhe të eksporteve kosovare. Për njëmbëdhjetë muajt e

vitit 2011, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, kemi pasur një rritje të eksportit për mbi 5 për qind, ndërsa numri i bizneseve kosovare që eksportojnë në BE është në disa qindra. Pritet që këtë vit të ketë një aktivitet edhe më të madh tregtar të Kosovës me BE-në, posaçërisht në rritjen e eksportit duke iu falënderuar vazhdimisht të masave preferenciale tregtare nga Bashkimi Evropian.

SHKËMBIMET TREGTARE TË KOSOVËS GJATË VITIT 2011

Shkëmbimet tregtare të Kosovës gjatë vitit 2011 kanë arritur vlerën rreth 2 miliardë e 792 milionë euro, që tregon se ka rritje për 14.7 për qind më shumë se në vitin 2010. Sa i përket importeve ato kanë shënuar vlerën 2 miliardë e 479 milionë euro, vlerë e cila është më e lartë për 15.9 për qind në raport me vitin 2010.

Eksporti i mallrave ka shënuar vlerën prej 313 milionë euro, me rritje prej 6.5 për qind. Për këtë periudhë kohore mbulimi i

importit nga eksporti është 12.6 për qind. Tregtia me vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e rajonit (CEFTA) përbëjnë pjesën dërmuese të tregtisë së jashtme të Kosovës, duke mbuluar 72.7 për qind të tregtisë së përgjithshme.

Eksportet e Kosovës për në

BE - sa i përket volumit të eksporteve, sipas destinacionit, edhe gjatë vitit 2011 pjesa më e madhe eksporteve të Kosovës kanë qenë të orientuara drejt vendeve të BE-

së, duke arritur në vlerën në 135 mil/€ ose 43.2 për qind e totalit të eksporteve. Kjo do të thotë se rritja e eksporteve kundrejt vitit 2010 është për 2.9 për qind.

Tregtia e jashtme e Kosovës me vendet anëtare të CEFTA-s:

- Duke parë ecurinë e qarkullimit tregtare me vendet e CEFTA-s, që arrin vlerën prej 953 mil/€, shihet se gjatë vitit 2011 ka rritje për 9.6 për qind nga viti 2010. Urse vlera e importit është mbi 871 mil/€ ose 35për qind nga vlera e përgjithshme e importit. Ky tregues tregon rritje të importit me këto vende për 9.1 për qind në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Eksportet me destinacion ndaj vendeve të rajoni anëtare në CEFTA kapin vlerën mbi 82 mil/€ ose 26.3 për qind nga vlera totale e eksporteve, vlerë e cila tregon ecuri pozitive nga se është më e lartë për 16 për qind krahasuar me vitin 2010.



Rezervat shtetërore të mallrave

Departamenti i Rezervave Shtetërore të Mallrave, bazuar në Ligjin për rezervat shtetërore të Mallrave, është themeluar në qershor të vitit 2011 dhe është pjesë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Gjatë kësaj periudhe, ky departament ka përgatitur akte nënligjore dhe rregulla për funksionimin e mirëfillt të rezervave shtetërore në Kosovë. Po ashtu aktivitet tjetër ka qenë edhe përgatitja e Planit strategjik dhe Programit vjetor, në bashkëpunim me përfaqësuesit e ministrive të fushës të përcaktuar, duke u përcaktuar për ato produkte të cilat konsiderohen si më të rëndësishme dhe të domosdoshme për të intervenuar në raste të jashtëzakonshme të parapara në ligj.

Për këtë është planifikuar buxheti për furnizim me

produkte të rezervës për vitin 2012 edhe përkundër mundësive të limituara buxhetore.

Pavarësisht kësaj, me iniciativën e ministres së MTI-së, Mimoza Kusari-Lila, për shkak të kushteve të krijuara pas reshjeve të borës dhe ngujimit të shumë banorëve në vise të ndryshme në territorin e Republikës së Kosovës është gjetur mundësia brenda fondeve të MTI-së për të intervenuar me një subvencion simbolik, në vlerë prej 50 mijë eurosh, për t'i ndihmuar banorët e ngujuar nga bora. Pas vlerësimit të gjendjes nga Kryqi i Kuq janë shpërndarë artikuj të produkteve ushqimore për këta nevojtarë.

MBROJTJA E KONSUMATORIT

Thirrni në **0800 11000**

www.mti-ks.org

Falas

19 janar 2012

Ministrja e MTI-së, Mimoza Kusari – Lila takoi kryetarin e Komunës së Ferizajt, me të cilin diskutuan për bashkëpunimin në mes të pushtetit qendror dhe lokal. Temë e diskutimit ishte edhe kalimi i inspektorateve komunale të tregut nga menaxhimi në nivelin lokal në menaxhim të nivelit qendror, respektivisht tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Ferizajt, Bajrush Xhemajli premtoi mbajtjen e një takimi të Bordit dhe Këshillit të Kryetarëve të Komunave për të marrë pëlqimin e të gjithë kryetarëve të komunave për këtë ndryshim.

20 janar 2012:

Ministrja Kusari – Lila takoi kryetarin e Lipjanit: Të dy bashkëbiseduesit kanë diskutuar për bashkëpunimin në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal me fokus të veçantë kanë diskutuar lidhur me implementimin e Ligjit të inspektoratit të tregut, sipas të cilit bëhet kalimi i inspektorëve të tregut nga menaxhimi në nivel lokal në menaxhim të nivelit qendror.

1 mars 2012:

Ministrja Kusari-Lila u takua me kryetarin e Komunës së Rahovecit, Smajl Latifin: Në takim u bisedua për ngritjen e bashkëpunimit publiko-privat dhe përkrahjes së bizneseve kosovare. Me këtë rast, ministrja Kusari-Lila hapi tre çështje si: kalimi i Inspektoratit komunal të tregut nga niveli lokal në nivel qendror, funksionimi i qendrave për regjistrimin e biznesit, si dhe promovimi i investimeve. Më pas ministrja Kusari-Lila vizitoi edhe disa biznese në rajonin e Prizrenit.

20 mars 2012:

Ministrja Kusari-Lila u takua me kryetarin e Komunës së Graçanicës, Bojan Stojanoviç: Gjatë këtij takimi është diskutuar për bashkëpunimin në mes të pushtetit qendror dhe lokal, me fokus të veçantë rreth diskutimit të Ligjit mbi inspektoratit dhe funksionimit të qendrës së regjistrimit të biznesit në këtë komunë.

23 mars 2012:

Ministrja Kusari – Lila takoi asociacionin e kryetarëve të komunave: Me qëllim të koordinimit dhe bashkëpunimit më të afërt për të koordinuar aktivitetet për reformat dhe lehtësirat që janë duke u bërë në të bërit biznes, ministrja Mimoza Kusari – Lila mbajti takim me kryetarët e komunave, ku u diskutua për dy ligje shumë të rëndësishme: Ligjin për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut dhe Ligjin për Tregun e Brendshëm. Ligjin i ri i Inspektoratit të Tregut parashih integrimin e plotë të inspektorateve komunale të tregut dhe Inspektoratit qendror në një ombrellë

Në vazhden e takimeve të ministres së MTI-së, Mimoza Kusari-Lila me kryetarët e komunave për të koordinuar aktivitetet rreth reformave dhe lehtësirave që janë duke u ndërmarrë për të bërë biznes në Kosovë.



të vetme për të funksionuar në mënyrë vertikale si alternativë e vetme për mbikëqyrje efikase dhe unike të tregut në kushtet e Kosovës.

9 janar 2012:

Zv.kryeministrja Mimoza Kusari-Lila vizitoi kompanitë "Laberion" dhe "KosovaTex": Me qëllim të njoftimit dhe të ndikimit të kthimit të preferencave tregtare nga BE-ja dhe për të parë gjendjen e përgjithshme të prodhuesve kosovarë, zv.kryeministrja dhe ministrja e MTI-së, Kusari-Lila vizitoi këto dy kompani, ku u njoftua me kapacitetet e tyre prodhuese, si dhe me potencialet e tyre eksportuese në vendet e BE-së. Me këtë rast, ajo potencoi përkushtimin e Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për të vazhduar me eliminimin e barrierave tregtare për të pasur qasje sa më të lehtë prodhuesit kosovarë në tregjet rajonale, evropiane dhe botërore.

31 janar 2012:

Ministrja Mimoza Kusari-Lila mori pjesë sot në ndarjen e 18 grandeve për ide biznesi të dhënë nga USAID: Në raundin e parë të ndarjes së grandeve "Programi i Ndërmarrësve të Rinj" (Young Entrepre-



neurs Program) zgjodhi 18 biznes-planet më të mira duke i mbështetur me nga 5 mijë euro secilin prej tyre. Ky program u ka ndihmuar ndërmarrësve të rinj në përgatitjen e biznes-planeve, si dhe do t'i përkrahë gjatë tërë vitit. Me këtë rast, zv.kryeministria Kusari-Lila tha "Të krijosh vende të punës për 20 deri 30 mijë të rinj, çdo vit dhe të cilët janë të kualifikuar, është një punë dhe ngarkesë e madhe. Jo për faktin se nuk është e mundur, por për faktin se duhet të gjithë ato ide dhe kreacione që ata i kanë të kanalizohen në vendin e drejtë"

12 janar 2012

Ministria Kusari – Lila përgëzoi planin e "Sharrcem"-it të ri: Në konferencën "Sharrcemi i ri", zëvendëskryeministria Kusari – Lila përgëzoi konceptin që është duke u promovuar nga "Sharrcem" dhe njëherësh u bëri thirrje të gjithë investitorëve vendorë dhe ndërkombëtarë se janë të mirëpritur që të investojnë në Kosovë dhe se e kanë edhe përkrahjen e plotë të Qeverisë së Kosovës.

13 janar 2012

Ministria Kusari – Lila vizitoi bizneset në Gjakovë: Ministria Mimoza Kusari-Lila, vizitoi tri kompani në Komunën e Gjakovës, me qëllim të ngritjes së dialogut publiko-privat dhe me njoftimin më të afërt me punën dhe sfidat e bizneseve. Fillimisht, zv. kryeministria Kusari Lila vizitoi kompaninë për prodhimin e vezëve dhe të mishit të zogut të freskët "Konsoni", pastaj kompaninë për prodhimin e gypave plastik "Inova" dhe më pas kompaninë e tekstilit "Wear and Go".

21 janar 2012:

MTI njofton bizneset kosovare mbi ligjet për mbrojtje të prodhimit vendor: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës dhe Aleancën Kosovare të Biznesit, organizuan konferencë për të njoftuar bizneset kosovare me Ligjin për masat mbrojtëse dhe Ligjin për masat

anti-damping. Ministria Kusari - Lila i njoftoi bizneset për reformat që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ndërmarrë rishtazi, si dhe për planet e mëtutjeshme që kanë për qëllim lehtësimin e ambientit për të bërë biznes.

15 shkurt 2012

Zëvendëskryeministria Mimoza Kusari – Lila mori pjesë në tryezën "Rolin e medieve në trajtimin e çështjeve gjinore", ku diskutuan për rolin e femrave në vendimmarrje. Zv.kryeministria Kusari-Lila potencoi se është shënuar progres në barazinë gjinore, por ka ende punë për t'u bërë. Gjithashtu, Kusari-Lila dha mesazh të qartë se mediet duhet të punojnë në çrrënjosjen e stereotipeve, shmangien e fjalorit diskriminues dhe në afirmimin e gjuhës së tolerancës.

2 shkurt 2012

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Mimoza Kusari-Lila mori pjesë në konferencën "Tërheqja e investimeve të Diasporës në Kosovë": Ministria Kusari – Lila prezantoi punën, që MTI është duke bërë për tërheqjen e investimeve të diasporës në Kosovë dhe e cilësoi diasporën si pjesë shumë të rëndësishme të ekonomisë sonë. Po ashtu, ministria Kusari-Lila prezantoi edhe planet e tërheqjes së investimeve të diasporës në Kosovë, të cilat ndërlidhen direkt me dy agjenci që veprojnë në kuadër të MTI-së (ARBK për hapjen e qendrave të regjistrimit të bizneseve dhe APIK për promovim e mundësive investuese në Kosovë).

9 shkurt 2012

Ministria e MTI-së, Mimoza Kusari – Lila, mori pjesë në hapjen zyrtare të panairit BizTECH, i cili ka për qëllim bashkëpunimet në mes të Kosovës dhe rajonit për aplikacionet softuerike.

Në fjalën e saj, ministria Kusari – Lila i informoi të pranishmit se sektori i teknologjisë informative është identifikuar si njëri ndër sektorët me potencialin më të madh zhvillimor në kuadër të ekonomisë kosovare dhe se agjencitë qeveritare janë duke punuar inten-



sivisht që të zhvillojnë masa dhe plane konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.

28 shkurt 2012:

Është shënuar progres në raportet tregtare Kosovë – BE: Ministria Mimoza Kusari -Lila mori pjesë në takim "Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit", të organizuar nga Zyra e Unionit Evropian në Kosovë. Në këtë takim u prezantuan të arriturat dhe sfidat e Kosovës. Tema me rëndësi që u diskutuan ishin: tregtia, industria, politikat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, doganat dhe tatimi. Rreth aktiviteteve dhe reformave që janë duke u ndërmarrë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ministria Kusari-Lila prezantoi përgatitjen e ligjeve të reja dhe modifikimeve të ligjeve që lehtësojnë aktivitetin dhe rregullojnë aktivitetin afarist në Kosovë. Po ashtu, ministria prezantoi edhe reformat që janë duke u ndërmarrë për të bërë biznes, që njëherësh ndihmojnë në implementimin e Aktit Evropian të Biznesit.

5 mars 2012:

Ministria Kusari – Lila inkurajon bizneset franceze të investojnë në Kosovë: Për herë të parë një grup i biznesmenësh francezë, me ndihmën e Ambasadës Franceze dhe të Odës Ekonomike të Kosovës, vizitojnë Kosovën me qëllim të shqyrtimit të bashkëpunimit me kompanitë kosovare. Me këtë rast, Ministria Kusari-Lila i informoi biznesmenët francezë për politikat që është duke i ndërmarrë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, të cilën e drejton, për krijimin e kushteve të favorshme dhe mundësive të shumta për investitorët e jashtëm.

Me qëllim të sensibilizimit dhe të promovimit të Kosovës jashtë vendit, zv.kryeministria dhe ministria e MTI-së, Mimoza Kusari-Lila zhvilloi aktivitete në shtete të ndryshme.

15 mars 2012:

Në seminarin e organizuar nga Akademia Diplomatike e Vjenës, Iniciativa e Stabilitetit Evropian dhe



Ambasada Britaneze në Vjenë, zv. kryeministria Mimoza Kusari-Lila mbajti fjalim për adresimin e sfidave të zhvillimit ekonomik të Kosovës, të cilat i ndau në tre sfera: struktura e ekonomisë sonë, qeverisja ekonomike pas luftës dhe struktura e shoqërisë tonë. Më tej, ministria foli edhe për politikat tregtare, ku sfida mbetet ngritja e kapaciteteve administrative, mbikëqyrja e tregut, mbrojtja e konsumatorit, prokurimi publik dhe politikat për lëvizjen e lirë të mallrave.

Po ashtu u prezantuan edhe kushtet dhe favorët që ofron Kosova për investime të jashtme.

8 mars 2012:

Me qëllim të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, në Berlin, u mbajt konferenca "Investoni në Kosovë", të organizuar nga Iniciativa Ekonomike për Kosovë dhe Agjencia për Promovimin e Investimeve. Në këtë konferencë, zv. kryeministria, Mimoza Kusari – Lila, prezantoi kushtet për të bërë biznes në Kosovë, si dhe mundësitë e shumta që ofron Kosova për investime për shkak të pozitës së mirë strategjike dhe fuqisë punëtore më të lirë në Eurozonë.



30 mars 2012:

Ministria Kusari – Lila: "Diaspora fuqia më e madhe investuese që ka Kosova": Nën organizimin e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim dhe Institutit për Menaxhim dhe Zhvillim është prezantuar projekti: "Diaspora për zhvillim", ku qëllimi kryesor i këtij projekti katër vjeçar është stimulimi i diasporën që të investojë burimet (njohuritë, eksperiencën dhe financat) në nismat sociale dhe ekonomike në Kosovë.

Në këtë takim, ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari – Lila prezantoi punën e ministrisë të cilën ajo e drejton për ofrimin e mundësive për investime nga Diaspora.